



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 23.4.2024, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Triera Kasumi Berisha, Faton Marolli, Kimeta Shok, Adnan Ajeti.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Betim Abdullahu - udhëheqës i ZKKK-ës, Klaudia Mula- zyrtare për Komunitete në ZKKK, Fisnik Dida - OSBE, Arianita Beqa Rraci - UNMIK, Melai Daniele, KFOR, Fadil Aliu - udhëheqës i personelit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë;

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për shefin e personelit z. Fadil Aliu, të na njoftojë lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë si në përfaqësim ashtu edhe në punësim;
3. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Jehona Lushaku Sadriu;
4. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Sportit z. Bardh Krasniqi, të na njoftojë lidhur me planin e drejtorisë për vitin 2024;
5. Raporti i ZKKK-ës për muajin mars 2024;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
7. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për shefin e personelit z. Fadil Aliu, të na njoftojë lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë si në përfaqësim ashtu edhe në punësim.

Mirsada Behluli – duke falënderuar z. Aliu për prezencën e tij në takim njëkohësisht shtroi pyetje lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë në përfaqësim të punësimit. Ajo në vazhdim tha se meqë para 1 viti kemi pasur takim me juve dhe kemi marrë informatë rreth punësimit dhe përfaqësimit të komuniteteve joshumicë. Pra më kujtohet shumë mirë që e keni përmendur, që në atë kohë ka pasur 84 konkurse, meqë ne jemi të interesuar për komunitetet joshumicë dhe na keni thënë se asnë nga komuniteti joshumicë nuk është lajmëruar, në ato konkurse. Prandaj për këtë vit na intereson d.m.th për këtë periudhë njëvjeçare a është lajmëruar dikush prej komuniteteve në konkurse, a është punëuar dikush nga komunitetet dhe të na informoni për diçka nëse ne duhet të dimë për konkurs, për komunitetet joshumicë sa ju përket juve si përgjegjës.

Fadil Aliu - sa i përket pyetjes së znj. Behluli tha se më kujtohet vitin e kaluar kur kam qenë para jush dhe ju kam treguar për mbarëvajtjen e shumë konkurseve të asaj kohe, fatkeqësisht në ato konkurse edhe pse janë inkurajuar pjesëtarët e komuniteteve në secilin konkurs që e publikojmë inkurajohen me aplikuar për shkak të kuotës që e kemi pasur obligim edhe me ligj, nuk ka pasur të interesuar. Nga prilli i viti të kaluar deri më sot, ka ndodhur ndryshimi i ligjit, i cili është në favor jo vetëm të komuniteteve, por është në favor të administratës në kuptimin për me ardhur deri te synimi që po mendojmë. P.sh. ligji i kaluar nuk i ka veçuar në procedura të veçanta gjatë rekrutimit pjesëtarët e komuniteteve, mirëpo ligji nga shtatori i viti të kaluar na jep mundësinë me shpall në procedura për dy kategori, në mënyrë të veçantë me i pa dhe me i veçuar në konkurs vetëm personat me aftësi të kufizuar. Ai mes tjerash tha se tash e kemi pasur konkursin në arsim, ashtu mundem me thanë një mini-konkurs, ka qenë një pozitë për komunitete dhe duhet me qenë i komunitetit boshnjak dhe jam i lumtur të deklaroj se kemi pas të interesuar dhe është përzgjedhur një person. Po ashtu në konkursin për shëndetësi, konkursi ka qenë i barabartë dhe i njëjtë si për të gjitha komunitetet, si për shqiptarë dhe kemi pasur fatin ka aplikuar një doktor, një banor i Graçanicës, i komunitetit serb. Kam qenë i lumtur se ka aplikura dhe përfundimisht po thehet njëfar tabuje një arë barriere, ku edhe pjesëtarët e komuniteteve të aplikojnë në pozitat që publikohen.

Triera Kasumi Berisha - tha i kam dy pyetje, e para, a vlerësoni që konkurset ndoshta nuk janë duke u promovuar mjaftueshmë për kategorinë që ne e përfaqësojmë, d.m.th. në këtë komunitet?, dhe e dyta, a mendoni se duhet të krijohen mekanizma tjerë për me u promovuar më tepër konkurset, që me pas pjesëmarrje më të madhe të aplikimit, dhe a e vlerësoni se ka ndonjë mekanizëm që ne si Komitet i komuniteteve mund të kontribuojmë, të bëjmë thirrje më shumë për pjesëmarrje të pakicave në konkurse.

Fadil Aliu – lidhur me pyetjet e znj. Kasumi tha se fatkeqësisht tash e dy vite po e shoh se nuk ka shumë të interesuar edhe është për çudi sepse ligji edhe në të kaluarën iu ka dhënë prioritet personave me nevoja të veçanta dhe komuniteteve. Tash nuk i ka dhënë prioritet në kuptim që një person është me nevoja të veçanta dhe t'i jepen pikë më shumë, por nëse janë të barabartë me pikë, gjithmonë e ka favorizuar, por ne nuk po kemi aplikantë. Ai në mes tjerash tha se ligji neve na imponon të shpallim konkurs sepse ju e dini që konkurset janë online, sepse jemi duke biseduar për shërbYESIT civilë edhe përvëç se duhet me aplikura në (SIMBNJ), Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, çdo konkurs e kemi me ligj me publiku edhe në web faqen zyrtare të komunës, ku edhe për burimet njerëzore do të ishte jashtëzakonisht e mirëseardhur

edhe një ndihmë shumë e madhe nëse ju si komision këtu që jeni me hy vetë aty, të merrni linkun dhe ta përcjellni tek organizatat apo aty ku mendoni ju që kanë shumë anëtarësim, në mënyrë që me ju imponuar për të aplikuar në konkurse.

Triera Kasumi Berisha – shtroi pyetje se a kanë organizuar ndonjëherë institucionet përgjegjëse që e menaxhojnë platformën në fjalë që të krijojnë udhëzues.

Fadil Aliu - sa i përket pyetjes së shtruar nga znj. Kasumi tha se po ekziston udhëzuesi dhe jam i gatshëm nëse ju si komision bisedoni me organizata të ndryshme dhe e vërtetoni se ata nuk kanë njohuri, ta identifikoni nga një persona prej secilës organizatë, mandej unë e kisha organizuar një trajnim se qysht ta bëjmë regjistrimin që anëtarët e tyre në mënyrë se si të aplikojnë. Nuk na kish marrë më tepër se gjysmë dite trajnim kohë, sepse konkurset kur i publikoj, i publikoj edhe në you tube se si është forma me aplikuar. Tuttje tha se diku është duke çaluar, se nuk po kemi aplikim të këtyre personave me nevoja të veçanta dhe të komuniteteve. E këtu më duhet ndihma juaj, ndihma juaj për t'i identifikuar nga këndvështrimi i këtyre organizatave se ku çalon problemi.

Mirsada Behluli - tha unë do të kisha propozuar se kur janë në pyetje komunitetet joshumicë dhe personat me nevoja të veçanta, ndoshta kishte me qenë mirë që në Zyrën e komuniteteve komunale t'i dërgoni konkurset dhe ata të na njoftojnë neve si komunitet dhe të na paraqesin takime në mënyrë që të jemi të informuar.

Fadil Aliu - duke iu përgjigjur znj. Behluli tha se ato janë publike, afati i aplikimit është 30 ditë, bukur është i gjatë, më keni dhënë edhe një ide, tash do të bisedoj edhe me Betimin edhe do të insistoj që ky me ia dërguar nëse ka ndonjë vend.

Betim Abdullahu- duke u ndërlidhur në diskutim tha se sa herë që ka pasur konkurse apo edhe njoftime prej drejtive për subvacione, ne gjithmonë jo vetëm në komunitet por edhe juve si anëtarë të komitetit ju kemi njoftuar gjithmonë me e-maila dhe asnjëherë nuk kemi thënë se nuk asistojmë për me ju ndihmuar. Pastaj tha se është edhe një mënyrë tjetër, zakonisht konkurset në administratë nga niveli qendror dhe komunal, minimalisht duhet të kenë fakultetin e përfunduar. Personi i cili e ka përfunduar fakultetin di me hy edhe në SIMBNJ, por interesin nuk e kanë, kurse kurdo që është dikush që nuk di me u qas ose nuk di me u regjistruar zyra jonë është e hapur, ne e njohim sistemin dhe nuk është telashe për me asistuar, por deri sot që po flasim as edhe njëherë, dikush nuk ka kërkuar as ndihmën më të vogël që nuk po dimë dhe se nuk kemi pasur mundësi me aplikuar.

Nenad Miladinović- duke u ndërlidhur në diskutim tha se sa i përket konkurseve mendoj se komunitetet joshumicë nuk janë të informuara sa duhet, prandaj edhe po ndodh mosinteresimi i tyre për aplikim në vende të punës. Pra mendoj se nëpërmes të këtij komiteti të informohen komunitetet joshumicë rrëth konkurseve etj. Ai në vazhdim tha se vërtet nuk jemi të informuar, këtë mund ta vërtetojnë edhe anëtarët e tjerë të komisionit të komunitetit. Sa i përket numrit të punësuarve, është fjala për komunitetin serb, në arsim nga komuniteti serb më herët kanë qenë 7, ndërsa tanë janë 5 persona dhe këto i shoh absolutisht të dhëna jo reale, të këtyre njerëzve të cilët punojnë në arsim, d.m.th ajo listë e tyre që punojnë është jo reale. Ai në mes tjerash tha se mundeni me tregu sa është reale për ju në Komunën e Prishtinës, jetojnë 500 serbë dhe asnjë nuk është i punësuar në Komunën e Prishtinës. I kemi disa serbë të cilët vetë e kanë trashëguar të cilët më herët kanë punuar në Komunën e Prishtinës, por nuk jetojnë në Komunën e Prishtinës. Unë nuk jam kundër atyre, të cilët punojnë d.m.th. po kërkoj nga ju që serbët të cilët jetojnë në Komunën e Prishtinës, paguajnë

Faqe 3 nga 7

tatime në Komunën e Prishtinës ata të punësohen në Komunën e Prishtinës. Sa i përket profileve të shkollimit i kemi të gjitha edhe me shkollë të lartë edhe me shkollë të mesme, kurse problemi më i madh i komunitetit serb është papunësia.

Fadil Aliu - duke u ndërlidhur në diskutim tha se sa i përket të punësuarve në arsim, nuk e di pse po thua sa janë reale dhe sa nuk janë reale se ata njërëz paguhen nga thesari i Republikës së Kosovës. Unë nuk jam inspektor që mundem me vlerësuar a janë duke punuar apo jo sepse ata kryejnë shërbime në sektorin e arsimit dhe mos me kryer punën ishte vërejtur mungesa e tyre dhe ishte shkëput kontrata. Ndërsa sa i përket çështjes të të punësuarve në Komunën e Prishtinës, ligji nuk lejon të bëjmë diskriminim në mes të banorëve të Komunës së Prishtinës dhe komunave tjera. Ligji vlen për punësime në Republikën e Kosovës, nuk thotë vetëm për Komunën e Prishtinës, por thotë në gjithë territorin e Kosovës, mundet ai i Dragashit të aplikojë këtu edhe një person me hy në web-faqen e Komunës së Prishtinës, afati është 30-ditor, asnjë konkurs nuk ju humbet një hyrë vetëm në baza javore e jo në bazë ditore, i sheh të gjitha konkurset të cilat shpalen, e mos të flas për SIMBNJ që ke më tepër mundësi me pa konkurse më të avancuara.

Nenad Miladinoviç - tha se po pajtohem sa i përket ligjit dhe procedurës, ju keni të drejtë, mirëpo vërejtja ime kryesore është se kur të dalin konkurset komuniteti serb është shumë pak i informuar.

Fadil Aliu - duke iu përgjigjur z. Miladinovic tha se ato janë publike në web-faqen e komunës janë zyrtare dhe në SIMBNJ, aty ke mundësi ashtu e parashev ligji, pasi që tani nuk ka gazeta të shkruara, mjafton një herë në javë vetëm një person me hy në web-faqen e Komunës së Prishtinës, afati është 30-ditor, asnjë konkurs nuk ju humbet një hyrë vetëm në baza javore e jo në bazë ditore, i sheh të gjitha konkurset të cilat shpalen, e mos të flas për SIMBNJ që ke më tepër mundësi me pa konkurse më të avancuara.

Oktay Kurtesh - shtroi pyetje lidhur me konkurset ku thotë se qe një vit nuk ka pasur kandidat.

Fadil Aliu - tha se ka konkurruar vetëm një turk për një paralele në shkollën Elena Gjika.

Oktay Kurtesh - duke u ndërlidhur në diskutim tha se ka konkurruar edhe një për motër medicinale, por nuk e ka pasur komplet dokumentacionin, ku në vazhdim tha se ka pas dhe konkurojnë edhe nga komuniteti turk, meqë emrat dhe mbiemrat nuk i kemi shumë ndryshe për dallim nga shqiptarët. Ai mes tjerash tha se komuniteti turk, sipas konkurseve nuk i dallojnë a është për komunitetin turk apo është për shumicë, ne konkurojmë ku të mundemi sepse e dimë edhe gjuhën shqipe edhe gjuhën turke, për këto gjuhet që përdoren në Kosovë të dyja i dimë. Në Prishtinë, sidomos ndoshta një përqindje e vogël, nuk e di edhe askush nuk mund të thotë se për shkak të gjuhës nuk kam mundësi me u punësuar.

Fadil Aliu - tha se në fazën paraprake, gjatë verifikimit, kriteri i konkursit thotë duhet ta ketë dokumentin 1,2,3,4 dhe 5, ne aty nuk i shikojmë me emra vetëm se a i kanë dokumentet sipas kriterit të konkursit për aplikim. Ai në vazhdim tha se deri tash nuk ka pasur ashtu, mirëpo për te ju, po, është kërkuar paralele turke, tani është kërkuar edhe për paralele boshnjake edhe është shumë interesant sepse kanë aplikuar se tani për paralele boshnjake i bie se duhet të jetë i atij kualifikimi, por duhet edhe të dijë gjuhën boshnjake. Ne nuk kemi thënë se kjo pozitë është vetëm për komunitetin boshnjak, por kemi thënë se është për paralele boshnjake, që do të thotë se kanë të drejtë aplikimi edhe shqiptarët edhe boshnjakët edhe serbët edhe turqit, të gjithë ata që e dinë gjuhën boshnjake.

Faqe 4 nga 7

Triera Kasumi Berisha - duke u ndërlidhur në diskutim tha se unë e kisha bërë një propozim në rast se të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete vlerësojnë se nuk është duke u bërë mjaftueshëm fushatë, ndoshta është mirë që komuna, njësia e juaj të bëjë një fushatë, një video ku bëhet thirrje në gjuhën e komuniteteve, për pjesëmarrje në të gjitha konkurret në Komunën e Prishtinës.

Betim Abdullahu - tha se secili anëtar i komunitetit e ka për detyrë për me i njoftuar komunitetet e veta.

Fadil Aliu - tha duhet pasur buxhet të caktuar dhe ne nuk kemi se jemi si sektor që i kemi vetëm pagat. Sa i përket në aspektin e punëve shtesë çdo ide që keni është e mirëseardhur, për atë po më vjen mirë se është edhe Betimi këtu dhe nëpërmjet Betimit e keni edhe e-mail adresën time. Nëse nuk ju hapet web-faqja unë mundem me ua dërguar edhe në e-maile të gjitha konkurret kur të shpallojnë. Jam shumë i interesuar që të ketë pjesëmarrje të komuniteteve në konkurse, por fatkeqësisht nuk po jam i kënaqur me pjesëmarrjen e tyre sepse nuk po ka shumë interesim.

Mirsada Behluli - duke u ndërlidhur në diskutim tha se vetëm një fjalë përfund, sa i përket komunitetet e kemi nga komunitetin goran, zonjën Kimete dhe nga komuniteti serb zotri Nenadin, të gjithë të angazhohemi nëse mundemi me i ndihmuar përfundësim, për ndonjë konkurs që i përshtatet komunitetit serb dhe goran. Këta me vite punojnë këtu dhe ju ndihmojnë komunitetit të tyre, por këta janë të dy pa punë.

Fadil Aliu - ky është diskriminim, ne nuk mundem ta bëjmë sepse ligji nuk na lejon sepse duhet me qenë pozitë e menduar për komunitete aty. Ne dimë se kush janë komunitetet në Kosovë dhe nuk mundemi aty as për komunitetet tjera. Ju kërkoj falje, por unë nuk mundem me vepruar ndryshe, vetëm sipas ligjit. Nuk e thotë ligji se ne duhet të bëjmë ndasi për komunitetin serb, goran, turk etj.

Pika e tretë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Jehona Lushaku Sadriu

Për shkak të mosmundësisë së pjesëmarrjes së drejtoreshës së Arsimit znj. Lushaku Sadriu, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet përtakimin e ardhshëm.

Pika e katërt

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Sportit z. Bardh Krasniqi, të na njoftojë lidhur me planin e drejtorisë përvitin 2024.

Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet përtakimin e ardhshëm.

Pika e pestë

Ftesë për zonjën Premtime Preniqi të na tregojë përraportin dhe sfidat për projektet e vitit 2024.

Betim Abdullahu - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se apo më kontaktuan nga Kabineti i kryetarit ku në pika të shkurta do të ju informojë për pikat kryesore në lidhje me aktivitetet 2024, prej Zyrës për barazi gjinore. Pra ka filluar aktiviteti për trajnimin për mësimdhënës kundër dhunës në familje, aktivitetet për të drejtat e fëmijëve dhe në fund do të mbahet asambleja e fëmijëve në Komunën e Prishtinës, do të organizohet aktivitet për persona me aftësi të kufizuara. Njëherazi ju kërkojë falje, por datat nuk i kam të sakta se kur do të mbahen, do të hartohet dokument për mekanizmin, kundër dhunës në familje, takim me gratë për trashëgiminë e pronës, fushatë kundër trafikimit me qenie njerëzore, është mbajtur edhe vitin e kaluar dy javë fushata edhe këtë vit do të mbahet fushata kundër trafikimit të qenieve njerëzore, shënim i Ditës ndërkombëtare i dhunës në familje dhe është hartuar komplet raporti për vitin 2023 për të gjitha aktivitetet çka kanë qenë.

Mirsada Behluli - unë do të kisha propozuar që ne Komiteti për Komunitete të ngrisim zërin ndaj çdo dhune sidomos dhunës në familje dhe të shprehim keqardhjen tonë dhe ndjenjën për dhunën në familje, me të cilën jemi ballafaquar ditëve të fundit në Kosovë. Pajtoheni të gjithë një zëri?. Këtu aktualisht ka pasur shumë probleme dhe vrasje dhe atëherë vetëm të bashkëndjejmë të gjithë së bashku për këtë situatë.

Pika e gjashtë

Raporti i ZKKK-ës për muajin mars 2024.

Klaudia Mula - sa i përket raportit mujor prej Zyrës së komuniteteve tha se janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet që parashihen në planin e punës të zyrës për vitin 2024. Aktivitetet të cilat janë të parapara të planeve lokale për avancimin e të drejtave të komuniteteve, Planin lokal të veprimit për integrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e azilkërkuesve. Sa i përket aktivitetet e ditore mendoj se i keni pranuar të gjithë ajo çka duhet të ceket ka filluar, fushata për regjistrimin civil falas për komunitetin romë, ashkali dhe egjiptian. Kjo kampanjë ka filluar nga 15 prilli dhe zgjatë deri më 15 maj 2024. Duke iu bërë thirrje këtyre komuniteteve që të shfrytëzojnë këtë mundësi dhe t'i nxjerrin dokumentet të cilat kanë nevojë. Gjithashu përpos komunitetit boshnjak nuk ka listë tjetër, kurse sa i përket aplikimit për dru zjarri nuk kam diçka tjetër të shtoj.

Elmira Nikçi Rexha - duke u ndërlidhur në diskutim tha se a ka mundësi që anëtarët e komuniteteve me na treguar pse nuk janë dorëzuar listat, ky është i treti takim d.m.th që janë kërkuar listat dhe ku qëndron problemi, pse nuk janë dorëzuar. Ajo në vazhdim tha se le të jetë si praktikë edhe për komunitetet tjera, që nëse keni dëshirë që anëtarët e komunitetit tuaj të kenë këtë lloj formati të takimit, pavarësisht a janë fëmijë apo grupe të ndryshme në kuadër të komuniteteve mundeni me u drejtuar edhe tek ne edhe tek zyra edhe tek kryesuesja me një kërkesë për t'ju realizuar ato takime. Në vazhdim tha se sa më herët është më mirë, pasi që ne e dimë se sa ka buxhet drejtoria dhe duhet me pa përmes Zyrës së kryetarit, sikur para dy viteve qysht kemi reaguar, e mos ta lëmë si vitin e kaluar në momentin e fundit në ç'rast nuk kemi pasur mundësi as të shtojmë as të largojmë. Kështu që ju bëjë thirrje dhe ju lutem me mirësi që lista deri në vikend ose eventualisht deri sot një javë të dorëzohet në zyrë, që me pas mundësi që edhe prej buxhetit shtesë për t'i përkrahur familjet në nevojë.

Pika e shtatë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre.

Nenad Miladinoviç - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se pa dashur t'i përsërisë të njëjtat probleme, mbeturinat, qentë endacakë, në të gjitha takimet po i përsëris të njëjtat probleme, nga takimi në takim ky problem është vetëm më i madh.

Mirsada Behluli - sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se në Këshillin për siguri detajisht i kam informuar të gjitha komunitetet. Herën e kaluar drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe drejtori i Drejtorisë së Inspepcionit nuk i janë përgjigjur ftesës, por në takim ka qenë zyrtarja dhe i ka pranuar të gjitha ankesat dhe ka thënë se për 4 apo 5 muaj do të rregullohen të gjitha. Nnëse e shihni të arsyeshme do ta ftojmë në takimin e radhës drejtorin e shërbimeve publike dhe të inspepcionit edhe njëherë t'i paraqesim kërkesat tonë. Pas shumë diskutimesh dhe sugjerimesh u formua Komisioni për vizitat në Bërnicë, Slivovë dhe Lebanë në këtë përbërje; **Nenad Miladinovic, Slavica Stolic dhe Arianita Beqaj.**

Mbledhja ka përfunduar në orën 12:30

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli



Faqe 7 nga 7